Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Ministry of Education and Science

Në zbatim të nenit 17 të Ligjit nr. 08/L-153 për Edukim në Fëmijëri të Hershme, nenit 2 të Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XK të nënshkruar me datën 28.06.2024 nga Republika e Kosovës dhe Banka Botërore dhe vendimit nr. 01B-246 të datës 23.12.2024, Ministria e Arsimit dhe Shkencës hap:

THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMIN E KUPONËVE PËR FAMILJET E REGJISTRUARA NË SKEMËN E ASISTENCËS SOCIALE

Datë: 19.11.2026

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh), fton familjet përfituese të Skemës së Asistencës Sociale (SAS), të cilat kanë fëmijë të moshës 3-6 vjeç, të aplikojnë për subvencionimin e plotë të pagesës për vijimin e edukimit në institucione private dhe publiko-private të licencuara të edukimit në fëmijërinë e hershme, sipas zgjedhjes së familjeve për vitin shkollor 2026/27.

Familjet e regjistruara në SAS, të cilat banojnë në Vushtrri, Gjilan, Prishtinë, Pejë, Drenas, Lipjan, Ferizaj, Shtime, Viti, Fushë Kosovë, Suharekë, Gjakovë, Graçanicë, Mitrovicë, Klinë, Prizren, Obiliq, Podujevë, ftohen të aplikojnë për mundësinë për të përfituar nga kjo mbështetje.

Pjesëmarrja në Program të Kuponëve nuk do të ndikojë në përfitimet e familjeve nga Skema e Asistencës Sociale.

Mënyra e përkrahjes:

- Të drejtë aplikimi për Programin e Kuponëve kanë të gjitha familjet e regjistruara në Skemën e Asistencës Sociale të cilat kanë fëmijë të moshës 3-6 vjeç për vijimin e edukimit në institucionet private dhe publiko-private të licencuara për edukim në fëmijërinë e hershme.

- Forma e përkrahjes nga Programi i Kuponëve realizohet si mbështetje direkte për institucionet private dhe publiko-private të licencuara për edukim në fëmijërinë e hershme për vitin shkollor 2026/27 dhe për shërbimet e transportit aty ku ofrohet, dhe si përkrahje direkte te familja për transportin e fëmijëve në rastet kur ky shërbim nuk ofrohet nga institucionet, sipas kritereve të përcaktuara në udhëzuesin mbi funksionimin e programit të kuponëve.

Kriteret për aplikim janë:

- Familja duhet të jetë e regjistruar përfitues të Asistencës Sociale sipas listave të Ministrisë së Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare;
- Të ketë të paktën një fëmijë të moshës nga 3 deri në 6 vjeç në kohën e regjistrimit në kopsht. Mosha e fëmijës llogaritet nga data e ofrimit të shërbimit në kopsht, jo nga data e aplikimit në Program. Rrjedhimisht prindi apo kujdestari ligjor mund të aplikoj edhe para se fëmija të ketë mbushur moshën 3 apo 6 vjeç, duke filluar nga 2 vjeç e 6 muaj deri në moshën 5 vjeç e 6 muaj. Me kusht që vijimin në kopsht ta nis në moshën 3 vjeçare dhe ta përfundoj kur fëmija fillon edukimin e detyrueshëm parafillor apo fillor në një institucion publik arsimor;
- Fëmija duhet të ketë vendbanimin në komunën ku aplikon për ta vijuar kopshtin.

Të gjithë fëmijët të cilët i plotësojnë kriteret e lartpërmendura do t'i nënshtrohen përzgjedhjes në mënyrë të automatizuar të rastësishme në pajtim me Udhëzuesin e Programit të Kuponëve të miratuar me vendimin nr. 01B-246 datë 23.12.2024.

Shpenzimet të cilat do të mbulohen nga programi:

- Programi do të mbulojë pagesën e kopshtit për të gjithë ciklin e edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Pagesën për transport për fëmijët të cilët nuk janë në gjendje të udhëtojnë të sigurt të shoqëruar nga prindërit ose kujdestari i tyre ligjor, distanca e të cilëve është së paku 4 kilometra larg nga kopshti i përzgjedhur në procedurë të aplikimit. Shuma e pagesës së transportit do të përcaktohet nga Komisioni për vlerësimin e aplikimeve për Programin e Kuponëve, varësisht nga komuna përkatëse dhe distanca rrugore.

Procedura e aplikimit:

- Aplikimi realizohet vetëm nëpërmjet platformës e-Kosova, në vegëzën: https://rks-gov.net/596
- Aplikuesit mund të jenë vetëm prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve;
- Aplikuesit mund të aplikojnë për më shumë se një fëmijë.

Familjet që aktualisht përfitojnë nga Programi i Kuponëve dhe familjet që kanë përfituar nga ky program gjatë vitit shkollor 2025/26, fëmijët e të cilëve tani i takojnë grupmoshës 5-6 vjeç dhe që nuk kanë filluar edukimin e detyrueshëm parafillor në një institucion publik arsimor, ftohen të riaplikojnë nëpërmjet platformës e-Kosova, brenda afatit të kësaj thirrjeje, për konfirmimin dhe përditësimin e të

dhënave dhe dokumentacionit përkatës. Këto familje nuk i nënshtrohen sërish procesit të përzgjedhjes së rastësishme. Mbështetja u vazhdohet automatikisht për sa kohë që vazhdojnë t'i plotësojnë kushtet e Programit.

Për ndihmë rreth aplikimit, procesit të përfitimit dhe çdo çështjeje që keni në lidhje me Programin e Kuponëve, drejtohuni te Qendra për Punë Sociale (QPS) në komunën tuaj.

Të dhënat dhe dokumentet e kërkuara në procedurë të aplikimit janë:

- Emri e mbiemri i prindërve ose kujdestarit;
- Adresa;
- Regjioni;
- Numri i kontaktit;
- Numri i fëmijëve për të cilët ata kërkojnë mbështetje nga Programi i Kuponit;
- Emri e mbiemri i fëmijës/fëmijëve;
- Karta e ndihmës sociale;
- Nëse aplikuesi është kujdestar ligjor (dhe jo prindi) atëherë duhet të ngarkohet dëshmia për kujdestarinë ligjore;
- Dëshmia e vaksinimit, pasaporta e vaksinimit të fëmijëve;
- Përzgjedhja e Institucionit të Edukimit në Fëmijëri të Hershme (IEFH)/kopshtit brenda komunës së aplikuesit;
- Të dhëna nëse fëmija është me aftësi të kufizuar;
- Distanca nga vendbanimi për në IEFH/kopsht dhe të dhënat e xhirollogarisë bankare të prindit, nëse ka nevojë për transport.

Afati për aplikim:

Aplikimi është i hapur për 21 ditë, nga data **19.11.2026** dhe përfundon me datën **10.12.2026.**

Komisioni për vlerësimin e aplikimeve për Programin e Kuponëve, do të përpilojë listën përfundimtare të përfituesve brenda 15 ditëve pas mbylljes së procesit të aplikimit. Vendimi do të publikohet në kanalet zyrtare të MASh dhe do të ndahet me të gjithë aplikuesit përmes e-Kosova.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e telefonit: 038 200 65048 dhe/ose duke dërguar e-mail në adresën: programiikuponave@rks-gov.net.